



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë më 14.11.2022

Dokument Parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

(Shqyrtimi nen për nen)

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjet e datave 28, 31 tetor dhe 1, 2, 3, 4, 7, 8 dhe 14 nëntor 2022, bëri prezantimin nen për nen të projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2023” dhe zhvilloi seanca dëgjimore me institucionet e pavarura kushtetuese dhe institucionet e pavarura të krijuara me ligj, sipas fushës së veprimtarisë, në përgjegjësinë e këtij Komisioni, konkretisht me:

1. *Ministrinë e Drejtësisë;*
2. *Inspektorin e Lartë të Drejtësisë*
3. *Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit;*
4. *Prokurorinë e Përgjithshme;*
5. *Strukturën e Posaçme Anti Korrupsion;*
6. *Gjykatën Kushtetuese;*
7. *Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;*
8. *Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit;*
9. *Këshillin e Lartë të Prokurorisë;*
10. *Institucionin e Presidentit;*
11. *Kolegjin e Posaçëm të Apelit;*
12. *Komisionin e Pavarur të Kualifikimit;*
13. *Institucionin e Komisionerëve Publikë;*
14. *Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi;*
15. *Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*

16. *Këshillin e Lartë Gjyqësor;*
17. *Komisionin e Prokurimit Publik;*
18. *Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;*
19. *Shoqatat përfaqësuese të njëjësive të vetqeverisjes vendore.*
20. *Autoritetin Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit;*
21. *Avokatin e Popullit;*
22. *Shkollën e Magjistraturës.*

Pas prezantimeve të kërkesave buxhetore nga titullarët dhe përfaqësuesit e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të pavarura të krijuara me ligj, Komisioni duke ndjekur parimin e domosdoshmërisë, prioritizimin e nevojave dhe shpenzimeve, si dhe mbajtjen e një raporti të drejtë midis kërkesave të institucioneve dhe mundësive që ofron ky projektbuxhet vendosi t'i propozojë Komisionit për Ekonominë dhe Financat ndryshimet e mëposhtme, të cilat sigurojnë rritjen e efikasitetit të punës së institucioneve dhe realizimin e investimeve të nevojshme kryesisht në sistemet digjitale dhe mbrojtjen kibernetike.

1. Për projektbuxhetin e Ministrisë së Drejtësisë

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për Ministrinë e Drejtësisë është rreth 11.97 miliardë lekë, nga të cilat:

- 5.98 miliardë lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore.
- 5.3 miliardë lekë shpenzime për mallra dhe shërbime.
- 690 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të kësaj ministrie për vitin 2023 është parashikuar të jetë 5378 punonjës.

Programet e kësaj ministrie të cilat do të sigurojnë dhe pjesën më të madhe të fondeve janë:

- Sistemi i burgjeve për të cilin do të alokohen afërsisht 6.7 miliard lekë ose 55.6% të totalit të fondeve dhe
- Shërbimi i kthimit dhe kompensimit të pronave për të cilin do të alokohen afërsisht 3.8 miliardë lekë ose 31.46% të totalit të fondeve.

Gjithashtu, në buxhetin e Ministrisë janë parashikuar 165 milion lekë për shërbimin e përmbartimit gjyqësor dhe 201 milion lekë për shërbimin e provës.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të kësaj ministrie janë rritur me rreth 944 milion lekë, ose 8.6% më shumë, nga të cilat:

- Shpenzimet korrente janë rritur me 838 milion lekë ose 8% më shumë.
- Shpenzimet për investime janë rritur me 106 milion lekë ose 18.1% më shumë.
- Numri i punonjësve është rritur me 10 punonjës më shumë se një vit më parë.

Në seancën dëgjimore të datës 28 tetor, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja, i cili për projektbuxhetin e vitit 2023, kërkoi që të merren parasysh shtesat e mëposhtme në zërin e investimeve publike:

- Shtesën prej 360 milion lekë për ngritjen e Institutit të Miturve në Mëzez, nëpërmjet të cilit synohet të bashkohet i gjithë zinxhiri institucional për të miturit që kanë nevojë për riintegrim në periudhën 6 mujore post dënim, si dhe të miturit që vuajnë dënimin për vepra të rënda penale, duke ofruar krijimin e një institucioni të hapur rezidencial si kudo në praktikat më të mira ndërkombëtare.
- Shtesën prej 30 milion lekë, për projektin “Përmirësim dhe mirëmbajtje e sistemit ALBIS”, me vlerë totale rreth 180 milion lekë.
- Shtesën prej 30 milion leke, për projektin “Dixhitalizimi i arkivave të QBZ”, me vlerë totale rreth 150 milion lekë.

Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vendosi t’i propozojë komisionit përgjegjës miratimin e shtesës në zërin e shpenzimeve për investime në vlerën totale prej 420 milion lekësh, për financimin e të tre projekteve të sipërpërmendura.

2. Për projektbuxhetin e Inpektorit të Lartë të Drejtësisë

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është rreth 262 milion lekë, nga të cilat:

- 190 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore.
- 20 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime.
- 52 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të këtij institucioni për vitin 2023 është parashikuar të jetë 93 punonjës.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të këtij institucioni janë rritur me rreth 12.3 milion lekë, ose 4.8% më shumë, nga të cilat:

- Shpenzimet korrente janë rritur me 24.3 milion lekë ose 13% më shumë.
- Shpenzimet për investime janë ulur me 12 milion lekë ose 18.8% më shumë.
- Numri i punonjësve nuk ka ndryshuar në krahasim me një vit më parë.

Në seancën dëgjimore të datës 28 tetor, kërkesat buxhetore për këtë institucion u parashtruan nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani, i cili për projektbuxhetin e vitit 2023, kërkoi që të merren parasysh shtesat e mëposhtme:

- Shtesën prej 8 punonjësish sipas ndryshimeve strukturore të propozuara.

- Shtesën prej 15 milion tek zëri i shpenzimeve për mallra dhe shërbime për të përballuar rritjen e numrit të punonjësve nga 93 në 101 dhe ndryshimet e tjera strukturore.
- Shtesën prej 35.3 milion shtesë tek shpenzimet kapitale kryesisht për përballimin e kostove shtesë për projektin e rikonstruksionit të godinës, për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit për Menaxhimin e Ankesave dhe Dokumenteve si dhe mirëmbajtjen e Dhomës së Serverave.

Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës, miratimin e:

- *Shtesës prej 8 punonjësish, pa efekte financiare shtesë në zërin e shpenzimeve për paga dhe kontribute.*
- *Shtesës prej 5 milion lekë në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për të përballuar rritjen e numrit të punonjësve nga 93 në 101.*
- *Shtesës në zërin e shpenzimeve për investime në vlerën totale prej 21 milion lekë, nga të cilat:*
 - *14 milion lekë për financimin e kostove shtesë për projektin e rikonstruksionit të godinës.*
 - *4 milion për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit për menaxhimin e ankesave dhe dokumenteve.*
 - *3 milion lekë për furnizimin dhe vendosjen e pajisjeve për dhomën e serverëve.*

3. Për projektbuxhetin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për këtë institucion është rreth 40 milion lekë, nga të cilat:

- 26 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 13 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime
- 1 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të këtij institucioni për vitin 2023 është parashikuar të jetë 19 punonjës.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të këtij institucioni janë rritur me rreth 2.8 milion lekë, ose 7.6% më shumë. Rritja është reflektuar në zërin e shpenzimeve korrente, ndërsa zëri i investimeve ka mbetur i pa ndryshuar.

Në seancën dëgjimore të datës 28 tetor, kërkesat buxhetore për këtë institucion u parashtruan nga Drejtori Ekzekutiv z. Çelo Hoxha, i cili paraqiti kërkesën për shtesën prej 3 punonjësish në organikën e këtij institucioni.

Komisioni vendosi ti propozojë komisionit përgjegjës miratimin e shtesës prej 3 punonjësish dhe reflektimin e kostove shtesë në zërin e pagave dhe kontributeve në vlerën 3 milion lekë.

4. Për projektbuxhetin e Prokurorisë së Përgjithshme

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për Prokurorinë e Përgjithshme është rreth 2.5 miliardë lekë, nga të cilat:

- 2.05 miliardë lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore dhe kontribute.
- 325 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime.
- 130 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2023 është parashikuar të jetë 958 punonjës, i njëjtë me vitin 2022.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të Prokurorisë së Përgjithshme janë rritur me rreth 241 milion lekë, ose 11% më shumë. Rritja e fondeve është pasqyruar tek shpenzimet korrente ndërsa investimet nuk kanë ndryshuar në krahasim me vitin 2022.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 31 tetor, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Sekretari i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme, i cili për projektbuxhetin e vitit 2023, kërkoi që të merren parasysh shtesat e mëposhtme:

- Shtesë në zërin e shpenzimeve për paga dhe kontribute në vlerën afërsisht 231 milion lekë dhe shtimin e 4 punonjësve shtesë në pozicionin këshilltar të Njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
- Shtesë në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 75 milion lekë për të përballuar shpenzimet për ekspertë mjeko ligjorë të akteve të ekspertimit të zjarreve dhe të Kadastrës si dhe mirëmbajtjen e sistemit të interceptimit.
- Shtesë në zërin e investimeve në vlerë të përgjithshme 128 milion lekë, nga të cilat 30 milion për projektet e ndërtimit ose rikonstruksionit të disa prokurorive në rrethe dhe të Prokurorisë së Apelit në Tiranë, ndërsa pjesa tjetër e fondeve të përdoret për projektin CAMS i cili është financim i BE-së dhe nëpërmjet të cilit do të bëhet e mundur ndjekja e çdo etape të cilën kalon një çështje.

Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vendosi t’i propozojë komisionit përgjegjës miratimin e:

- ***Shtesës prej 4 punonjësish në pozicionin këshilltar të Njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme, pa efekte financiare shtesë në shpenzimet për paga dhe kontribute.***

- *Shtesës në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 30 milion lekë, për të përballuar shpenzimet për ekspertë mjeko ligjorë dhe të akteve të ekspertimit të zjarreve.*
- *Shtesës prej 80 milion lekësh në zërin e shpenzimeve për investime, të ndarë si vijon:*
 - *30 milion për projektet e ndërtimit ose rikonstruksionit të disa prokurorive në rrethe dhe të Prokurorisë së Apelit në Tiranë.*
 - *50 milion lekë për financimin e sistemit CAMS.*

Gjithashtu, Komisioni vendosi t’i kërkojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të bashkëpunojë me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës për ndryshimin e akteve nënligjore në fuqi, në mënyrë që shërbimet për pagesat e akteve të ekspertimit të Kadastrës të kryhen pa pagesë midis institucioneve buxhetore.

5. Për projektbuxhetin e Strukturës së Posaçme Antikorrupsion

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për rreth 1.16 miliardë lekë, nga të cilat:

- 983 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore dhe kontribute.
- 128 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime.
- 50 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të SPAK-ut për vitin 2023 është parashikuar të jetë 256 punonjës.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të SPAK janë rritur me rreth 237 milion lekë, ose 26% më shumë, nga të cilat:

- Shpenzimet korrente janë rritur me 217 milion lekë ose 24% më shumë.
- Shpenzimet për investime janë rritur me 20 milion lekë ose 67% më shumë.
- Numri i punonjësve në krahasim me një vit më parë është rritur me 15 veta.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 31 tetor, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme z. Arben Kraja, i cili për projektbuxhetin e vitit 2023, kërkoi që të merren parasysh shtesat e mëposhtme:

- Shtesën prej 15 punonjësish dhe
- Shtesën në zërin e shpenzimeve për investime në vlerën totale prej 17.4 milion lekësh, të cilat nevojiten:
 - Për financimin e projektit “Blerje pajisje procedurale penale” në vlerën 6 milion lekë.
 - Për financimin e projektit “Blerje pajisje sigurie” të kërkuara nga Garda e Republikës në kuadër të forcimit të sigurisë së ambienteve të SPAK.

Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vendosi t’i propozojë komisionit përgjegjës miratimin e shtesës së numrit të punonjësve, pa efekte financiare në zërin e

shpenzimeve për paga dhe kontribute si dhe shtesës në zërin e shpenzimeve për investime në vlerën 17.4 milion lekë.

6. Për projektbuxhetin e Gjykatës Kushtetuese

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për rreth 166.5 milionë lekë, nga të cilat:

- 133 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore dhe kontribute.
- 28.5 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime.
- 4 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të Gjykatës Kushtetuese për vitin 2023 është parashikuar të jetë 62 punonjës, i njëjtë me vitin 2022.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të kësaj Gjykate janë rritur me rreth 0.6 milion lekë më shumë. Rritja e fondeve është pasqyruar në zërin e shpenzimeve korrente të cilat janë rritur me 15.6 milion lekë ose 11% më shumë. Ndërsa, shpenzimet për investime kanë pësuar ulje me 15 milion lekë në krahasim me buxhetin e akorduar gjatë 2022.

Në seancën dëgjimore të datës 1 nëntor, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese z. Eugen Papandile, i cili për projektbuxhetin e vitit 2023, kërkoi që të merren parasysh shtesat e mëposhtme:

- Shtesë në zërin e mallrave dhe shërbimeve në vlerën 4.92 milion lekë për përmbushjen e plotë të nevojave operative të institucionit.
- Shtesë në zërin e shpenzimeve për investime në vlerën 6 milion lekë që do shërbejë për mbrojtjen kibernetike dhe për marrjen e masave për instalimin e sistemit sinjalizues antizjarr.

Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vendosi t’i propozojë komisionit përgjegjës miratimin e shtesës në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 1.5 milion lekë dhe shtesës në zërin e shpenzimeve për investime në vlerën 6 milion lekë.

7. Për projektbuxhetin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për rreth 69 milionë lekë, nga të cilat:

- 49 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore dhe kontribute.
- 16.5 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime.
- 3 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të KMSHC-së për vitin 2023 është parashikuar të jetë 37 punonjës, sipas ndryshimeve të bëra nga korriku i këtij viti.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të KMSHC-së janë rritur me rreth 11.1 milion lekë ose 19.2% më shumë. Rritja e fondeve është pasqyruar si vijon:

- Shpenzimet korrente janë rritur me 9.1 milion lekë ose 16% më shumë.
- Shpenzimet për investime janë rritur me 2 milion lekë në krahasim me një vit më parë.

Në mbledhjen e Komisionit të datës 1 nëntor, Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Pranvera Strakosha nuk parashtroi kërkesa për shtesa të tjera mbi fondet e akorduara.

8. Për projektbuxhetin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për rreth 177.3 milionë lekë, nga të cilat:

- 137 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore dhe kontribute.
- 37 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime.
- 3 milion lekë shpenzimet për investime.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, rezulton se shpenzimet totale të ILDKPKI-së kanë rënë me rreth 13.2 milion lekë ose 7% më pak, nga të cilat:

- Shpenzimet korrente janë rritur me 16.8 milion lekë ose 11% më shumë se një vit më parë.
- Shpenzimet për investime kanë rënë me 30 milion lekë në krahasim me një vit më parë.

Gjatë seancës dëgjimore të datës 2 nëntor, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Sekretari i Përgjithshëm i ILDKPKI-së z. Arbër Basholli, i cili për projektbuxhetin e vitit 2023, kërkoi që të merren parasysh shtesat e mëposhtme:

- Shtesë në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 10 milion lekë për të përballuar veprimtarinë në kuadër të procesit të integritetit dhe GRECOS.
- Shtesë në zërin e investimeve në vlerën 22 milion lekë për projektin e nënshkrimit elektronik të deklaratave.

Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vendosi t’i propozojë komisionit përgjegjës miratimin e shtesës prej 10 milion lekësh në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime dhe shtesës prej 22 milion lekësh në zërin e shpenzimeve për investime.

9. Për projektbuxhetin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për rreth 162.6 milionë lekë, nga të cilat:

- 127.5 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore dhe kontribute.
- 25.1 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime.
- 10 milion lekë shpenzimet për investime.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të KLP-së kanë rritje me rreth 13 milion lekë ose 8.7% më pak. Ndryshimet e fondeve janë pasqyruar tek:

- Shpenzimet korrente janë rritur me 12.4 milion lekë ose 8.8% më shumë se një vit më parë.
- Shpenzimet për investime kanë rënë me 2 milion lekë ose 25% ,ë shumë me një vit më parë.

Gjatë seancës dëgjimore të datës 2 nëntor, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Kryetari i KLP-së z. Alfred Balla, i cili për projektbuxhetin e vitit 2023, kërkoi që të merren parasysh shtesat e mëposhtme:

- Shtesë në zërin e shpenzimeve për paga e kontribute në vlerën 18 milion lekë dhe shtesë të numrit të punonjësve me 13 veta.
- Shtesë në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 9.9 milion lekë, me qëllim plotësimin e nevojave si rrjedhojë e rritjes së numrit të punonjësve.
- Shtesë në zërin e shpenzimeve për investime në vlerën 18 milion lekë, të cilat nevojiten për blerjen e pajisjeve të zyrës dhe kompjuterike si dhe financimin e projektit të arkivës digjitale.

Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vendosi t’i propozojë komisionit përgjegjës miratimin e:

- ***Shtesës prej 13 punonjësish me efekte financiare shtesë në zërin e shpenzimeve për paga dhe kontribute në vlerën 10 milion lekë.***
- ***Shtesës në zërin e investime në vlerën 18 milion lekë për blerjen e pajisjeve të zyrës, arkivën digjitale dhe pajisjeve IT.***

10. Për projektbuxhetin e Institucionit të Presidencës

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për institucionin e Presidencës është rreth 259.4 milionë lekë lekë, nga të cilat:

- 127.4 milionë lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore dhe kontribute.
- 126 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime.
- 6 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të këtij institucioni për vitin 2023 është parashikuar të jetë 86 punonjës, i njëjtë me vitin 2022.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të Presidencës janë rritur me rreth 15.6 milion lekë, ose 6.4% më shumë, nga të cilat:

- Shpenzimet korrente janë rritur me 25.6 milion lekë ose 11% më shumë se një vit më parë.
- Shpenzimet për investime kanë ulje me 10 milion lekë ose 63% më pak se një vit më parë.

Në seancën dëgjimore të datës 2 nëntor, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës Z. Florian Kali, i cili kërkoi që të merren parasysh shtesat e mëposhtme:

- Shtesë në zërin e shpenzimeve për paga dhe kontribute në vlerën 36 milion lekë, për shtimin e 10 punonjësve dhe rritjen e nivelit të pagës në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike dhe Sektorin e IT, të cilat kanë një volum pune më të lartë.
- Shtesa në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 50 milion lekë, për veprimtarinë protokollare brenda dhe jashtë vendit të Presidentit.
- Shtesa në zërin e shpenzimeve për investime në vlerën 319 milion lekë me qëllim rikonstrukcionin e godinës së institucionit dhe vënien në punë të një sistemi të ri kondicionimi.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës miratimin e shtesave të mëposhtme:

- *Shtesë në shpenzimet për paga dhe kontribute në vlerën 10 milion lekësh për përballimin financiar të shtesës së 10 punonjësve.*
- *Shtesë në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 15 milion lekë për të siguruar veprimtarinë protokollare brenda dhe jashtë vendit të Presidentit.*
- *Shtesë në zërin e investimeve në vlerën 10 milion lekë për financimin e projektit të arkivës digjitale.*

11. Për projektbuxhetin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për KPK-në është rreth 275.4 milionë lekë lekë, nga të cilat:

- 239.6 milionë lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore dhe kontribute.
- 33.8 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime.
- 2 milion lekë shpenzimet për investime.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të KPK-së janë rritur me rreth 15.1 milion lekë, ose 5.8% më shumë. Rritja e fondeve është pasqyruar terësisht tek zëri i shpenzimeve korrente.

Në seancën dëgjimore të datës 3 nëntor, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Kryetarja e KPK-së znj. Pamela Qirko, e cila kërkoi që të merren parasysh shtesat e mëposhtme:

- Shtesa në shpenzimet për paga dhe kontribute në vlerën 74 milion lekësh për të bërë të mundur rrillogaritjen e drejtë të pagave të Komisionerëve dhe këshilltarëve të Njësisë së Shërbimit Ligjor.
- Shtesa në numrin e punonjësve me kontratë të përkohshme nga 6 në 8 veta.

Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës miratimin e shtesës për personelin e përkohshëm prej 8 punonjësish.

12. Për projektbuxhetin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për rreth 197.4 milionë lekë, nga të cilat:

- 186 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore dhe kontribute.
- 8.6 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime.
- 2 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të KPA-së për vitin 2023 është parashikuar të jetë 57 punonjës, i njëjtë si në vitin 2022.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të KPA-së janë rritur me 2.8 milion lekë, nga të cilat:

- Shpenzimet për paga dhe kontribute janë rritur me 15.8 milion lekë ose 9.2% më shumë.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë rënie me 13 milion lekë.
- Shpenzimet për investime janë të njëjta me një vit më parë.

Në seancën dëgjimore të datës 3 nëntor, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Kryetarja e këtij institucioni, znj. Albana Shtylla, e cila për projektbuxhetin e vitit 2023, kërkoi që të merren parasysh shtesat e mëposhtme:

- Shpenzimet për paga dhe kontribute me shtesë në vlerën 21.7 milionë lekë.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime me shtesë 15 milion lekë.
- Shpenzimet për investimet me shtesë 2.7 milion lekë, të cilat nevojiten për blerjen e një pajisje Scaner.

Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës miratimin e shtesës në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 15 milion lekë.

13. Për projektbuxhetin e Institucionit të Komisionerëve Publikë

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për rreth 90.2 milionë lekë, nga të cilat:

- 79.4 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore dhe kontribute.
- 9.3 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime.
- 1.5 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të institucionit për vitin 2023 është parashikuar të jetë 65 punonjës, i njëjtë si në vitin 2022.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale janë rritur me rreth 15.1 milion lekë ose 20% më shumë, nga të cilat:

- Shpenzimet korrente janë rritur me 14.1 milion lekë ose 19% më shumë.
- Shpenzimet për investime janë rritur me 0.9 milion lekë ose 50% , më shumë.

Në mbledhjen e Komisionit të datës 3 nëntor, Komisionerja znj. Irena Nino nuk parashtrroi kërkesa për shtesa të tjera mbi fondet e akorduara në projektbuxhet.

14. Për projektbuxhetin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për KMD-në është rreth 55.93 milionë lekë lekë, nga të cilat:

- 42.9 milionë lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore dhe kontribute.
- 11.8 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime.
- 1 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të KMD-së për vitin 2023 është parashikuar të jetë 34 punonjës, i njëjtë me vitin 2022.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të KMD-së janë rritur me rreth 4.8 milion lekë, ose 9.4% më shumë se një vit më parë. Rritja e fondeve është pasqyruar si vijon

- Shpenzimet për paga dhe kontribute janë rritur me 2.9 milion lekë.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur me 3.9 milion lekë.
- Shpenzimet për investime kanë rënë me 2 milion lekë.

Në seancën dëgjimore të datës 4 nëntor, institucioni u përfaqësua nga Komisioneri z. Robert Gajda, i cili nuk parashtrroi asnjë kërkesë për shtesa mbi fondet buxhetore të akorduara në projektligj.

15. Për projektbuxhetin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për KDIMDP-në është rreth 91.3 milionë lekë lekë, nga të cilat:

- 72.8 milionë lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore dhe kontribute.
- 17.2 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime.
- 1 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të KDIMDP -së për vitin 2023 është parashikuar të jetë 49 punonjës.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të KDIMDP -së janë rritur me rreth 11 milion lekë, ose 14% më shumë, nga të cilat:

- Shpenzimet për paga dhe kontribute janë rritur me 13.3 milion lekë.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur me 3.1 milion lekë.
- Shpenzimet për investime kanë rënë me 5.5 milion lekë.

Në seancën dëgjimore të datës 4 nëntor, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Komisioneri z. Besnik Dervishi, i cili parashtrroi kërkesat për shtesat e mëposhtme:

- Shtesë në zërin e shpenzimeve për paga e sigurime shoqërore në vlerën 17 milion lekë, me qëllim financimin e shtesës në strukturë prej 11 punonjësish.
- Shtesë në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 23 milion lekë si kosto administrative të përlogaritura për mbulimin e aktiviteteve të shtuara në veprimtarinë e Zyrës përfshirë dhe fushatën e ndërgjegjësimit pas miratimit të akteve të reja, kryesisht të legjislacionit të ri të mbrojtjes së të dhënave personale.
- Shtesë në zërin e shpenzimeve për investime në vlerën 44.5 milion lekë, për financimin e disa projekteve si “Krijimi, zhvillimi, administrimi dhe monitorimi i Regjistrimit elektronik të Komunikimeve Tregtare të pa Kërkuara”, “Programi aplikativ për automatizimin e proceseve të punës të Zyrës së Protokoll/arkivës”, etj.

Në përfundim të diskutimeve Komisioni, vendosi t’i propozojë komisionit përgjegjës miratimin e shtesave të mëposhtme:

- ***Shtesës prej 7 punonjësish pa efekte financiare shtesë në shpenzimet për paga dhe kontribute.***
- ***Shtesës në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 5 milion lekë si kosto administrative për numrin e shtuar të punonjësve dhe për mbulimin e aktiviteteve për fushatën e ndërgjegjësimit pas miratimit të akteve të reja.***
- ***Shtesë në zërin e investime në vlerën 8.5 milion, nga të cilat:***

- 5.5 milion për financimin e projektit “Krijimi, zhvillimi, administrimi dhe monitorimi i Regjistrimit elektronik të Komunikimeve Tregtare të pa Kërkuara” dhe
- 3 milion lekë për financimin e projektit “Regjistrin e subjekteve kontrollues

16. Për projektbuxhetin e Këshillit të Lartë Gjyqësor

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për KLGJ-në është rreth 3.9 miliardë lekë lekë, nga të cilat:

- 2.94 miliardë lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore dhe kontribute.
- 683 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime.
- 250 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të KLGJ -së për vitin 2023 është parashikuar të jetë 1749, ku janë shtuar 20 punonjës në krahasim me vitin 2022.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të KLGJ -së janë rritur me rreth 277 milion lekë, ose 7.7% më shumë, nga të cilat:

- Shpenzimet për paga dhe kontribute janë rritur me 229 milion lekë.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur me 207 milion lekë.
- Shpenzimet për investime kanë rënë me 162 milion lekë.

Në seancën dëgjimore të datës 4 nëntor, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Kryetarja e këtij institucioni, znj. Naureda Llagami, e cila për projektbuxhetin e vitit 2023, kërkoi që të merren parasysh shtesat në zërin e shpenzimeve për investime në vlerën 556 milion lekë, nga të cilat:

- Shtesë në vlerën 110.6 milion lekë për financimin e fazës së studim projektimit të ndërtimit të ndërtimit të godinave të reja për 6 gjykata Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit, Gjykatat e rrethëve Tiranë, Lezhë, Fier, Durrës.
- Shtesë në vlerën 212 milion lekë për programet softëare për gjykatat përfshirë këtu dhe projektin për zhvillimin e një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS.
- Shtesë në vlerën 233 milion lekë për blerje pajisje zyre, ku 223 milion lekë janë për projektin e sigurisë në gjykata, ndërsa 10 milion lekë kërkesë e gjyqtarëve për pajisje zyre.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vendosi t’i propozojë komisionit përgjegjës shtesat e mëposhtme në zërin e investimeve:

- ***Shtesën prej 10 punonjësish në pozicionin sekretar gjyqësor pa efekte financiare shtesë në zërin e shpenzimeve për paga dhe kontribute.***
- ***Shtesë në zërin e investimeve në vlerën 481 milion lekë, nga të cilat:***
 - ***47 milion shtesë në zërin e investimeve për studim projektim gjykatash.***

- 434 milion shtesë për financimin e projektit për zhvillimin e një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS dhe projektit të sigurisë për gjykatat (pajisja e gjykatave me mjete teknologjike të cilat mundësojnë monitorimin e çështjeve të sigurisë).

17. Për projektbuxhetin e Komisionit të Prokurimit Publik

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për KPP-në është rreth 81.4 milionë lekë, nga të cilat:

- 61 milionë lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 14.1 milionë lekë shpenzime për mallra dhe shërbime
- 6 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të institucionit për vitin 2023 është parashikuar të jetë 36 punonjës.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të KPP-së janë ulur me 10.5 milion lekë, ose 13% më pak, nga të cilat:

- Shpenzimet për paga janë rritur me 4.8 milion lekë ose 8.5% më shumë.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur me 3.7 milion lekë ose 36% më shumë.
- Shpenzimet për investime kanë rënie me 19 milion lekë.

Në seancën dëgjimore të datës 7 nëntor, kërkesat buxhetore për këtë institucion u parashtruan nga Kryetari z. Jonaid Myziri, i cili për projektbuxhetin e vitit 2023, kërkoi që të merren parasysh shtesat e mëposhtme:

- Shtesën në zërin e shpenzimeve për paga dhe kontribute në vlerën në 11.4 milion lekë, të lidhur drejtpërdrejtë me kërkesat për ndryshime strukturore prej 6 punonjësish më shumë të cilët do të kenë përgjegjësinë për publikimin dhe monitorimin e formularëve të ankesave, vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik si edhe mbajtjen e databasës së të dhënave shtetërore.
- Shtesën në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 8 milion lekë për organizimin, zhvillimin e trajnimeve/ëorkshopeve/konferencave si për përmbushjen e rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë dhe progres raporteteve të Komisionit European dhe për zhvillimin në Shqipëri në vitin 2023 të Konferencës vjetore të prokurimit në fushat e transparencës, teknologjisë dhe inovacionit me pjesëmarrje të përfaqësuesve të gjithë vendeve të Europës.
- Shtesën në zërin e shpenzimeve për investimeve në vlerën totale 20 milion lekë, të cilat do të bëjnë të mundur si rikonstrukcionin e zyrave të institucionit dhe të dhomës së serverit dhe financimin e projekteve për zhillimin e sistemit *E-ankesa*, krijimin e aplikacionit mobile për sistemin e ankesave elektronike dhe krijimin një info-point digjitale pranë zyrave të Komisionit të Prokurimit Publik.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vendosi ti propozojë komisionit përgjegjës miratimin e:

- Shtesës prej 6 punonjësish pa efekte financiare shtesë në shpenzimet për paga dhe kontribute.*
- Shtesës së shpenzimeve për mallra dhe shërbime 8 milion lekë për organizimin, zhvillimin trajnimeve /ëorkshopeve /konferencave për përmbushjen e rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë dhe progres raporteteve të Komisionit European.*
- Shtesës në zërin e shpenzimeve për investimeve në vlerën 5 milion lekë për vitin 2023, ndërsa shtesa totale e investimeve e shtrirë në tre vite është 15 milion lekë, për financimin e projekteve “Përditësim dhe zhillim i sistemit E-ankesa”*

18. Për projektbuxhetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për KQZ-në është rreth 213.8 milionë lekë, nga të cilat:

- 118.3 milionë lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 43.5 milionë lekë shpenzime për mallra dhe shërbime
- 40.2 transferta për buxhetet familjare dhe të individëve
- 11.5 milion lekë shpenzimet për investime.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të KPP-së janë ulur me 54.3 milion lekë, ose 20% më pak, nga të cilat:

- Shpenzimet për paga janë rritur me 9.1 milion lekë ose 8.3% më shumë.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur me 6.7 milion lekë ose 18% më shumë.
- Shpenzimet për investime kanë rënie me 70 milion lekë në krahasim me një vit më parë.

Në seancën dëgjimore të datës 7 nëntor, kërkesat buxhetore për këtë institucion u parashtruan nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merja, i cili për projektbuxhetin e vitit 2023, kërkoi që të merren parasysh shtesat e mëposhtme:

- Shtesën në zërin e shpenzimeve për paga dhe kontribute në vlerën 12.6 milion lekë për të përballuar ndryshimet e fundit strukturore, ku institucionit i janë shtuar dhe 10 punonjës të tjerë.
- Shtesë në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 756 mijë lekësh për përballimin e kostove operative si shpenzimet e karburantit.
- Shtesë në zërin e shpenzimeve për investime në vlerën totale 37.7 milion lekë, nga të cilat:
 - Shtesë në vlerën 8 milion lekë, për blerje automatësh
 - Shtesë në vlerën 12 milion lekë për projektin e digjitalizimit të arkivës.
 - Shtesë në vlerën 17.7 milion lekë për blerje pajisje zyrash për kompletimin e zyrave të reja.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vendosi ti propozojë komisionit përgjegjës miratimin e shtesës në zërin e investimeve në vlerën 10 milion lekë për blerjen e pajisjeve të zyrave të reja për personelin e KQZ-së si dhe reflektimin në tabelën 1, të buxhetit të ndryshimeve strukturore të fundit të miratuara nga Kuvendi për KQZ-në me 10 punonjës shtesë me efekt financiar shtesë në zërin e pagave dhe shpenzimeve 10 milion lekë.

19. Për projektbuxhetin e Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për AIDSSH-në është rreth 107.7 milionë lekë, nga të cilat:

- 89 milionë lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 16.7 milionë lekë shpenzime për mallra dhe shërbime
- 2 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të AIDSSH-së për vitin 2023 është parashikuar të jetë 65 punonjës.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale të AIDSSH-së janë ulur me rreth 61 milion lekë, ose 36% më pak, nga të cilat:

- Shpenzimet për paga janë rritur me 15.9 milion lekë ose 22% më shumë se një vit më parë.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur me 300 mijë lekë.
- Shpenzimet për investime kanë rënie me 77 milion lekë në krahasim me një vit më parë

Në seancën dëgjimore të datës 8 nëntor, kërkesat buxhetore për këtë institucion u parashtruan nga Kryetarja znj. Gentiana Sula, e cila për projektbuxhetin e vitit 2023, kërkoi që të merren parasyshtesat e mëposhtme:

- Shtesë prej 18 punonjësish, si rrjedhojë e detyrave të reja që i janë ngarkuar AIDSSH-së me ndryshimet e fundit ligjore, me efekte financiare në fondin e pagave dhe kontributeve në vlerën 25.6 milion lekë.
- Shtesë në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 45 milion lekë për për financimin e procesit të identifikimit dhe rikuperimit të personave të zhdukur, për financimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e softërit të arkivës digjitale dhe për botimet e aktivitetet e tjera përkujtimore.
- Shtesë në zërin e shpenzimeve për investime në vlerën 10.8 milion lekë për blerje pajisje IT dhe pajisje zyre.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vendosi ti propozojë komisionit përgjegjës miratimin e shtesave të mëposhtme:

- *Shtesën prej 8 punonjësish pa efekte financiare shtesë në shpenzimet për paga dhe kontribute.*
- *Shtesën në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 25 milion lekë për financimin e procesit të identifikimit dhe rikuperimit të personave të zhdukur, për financimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e softërit të arkivës digjitale dhe për botimet e aktivitetet e tjera përkujtimore.*
- *Shtesën në zërin e shpenzimeve për investime në vlerën 5 milion lekë.*

20. Për projektbuxhetin e Avokatit të Popullit:

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për Avokatin është rreth 135 milionë lekë, nga të cilat:

- 108 milionë lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 20.6 milionë lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 4 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të këtij institucioni për vitin 2023 është parashikuar të jetë 57 punonjës.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale janë rritur me 10.2 milion lekë, ose 8.2% më shumë, nga të cilat:

- Shpenzimet për paga janë rritur me 8.1 milion lekë ose 8% më shumë se një vit më parë.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur me 4.4 milion lekë ose 27% më shumë se një vit më parë.
- Shpenzimet për investime nuk kanë ndryshime.

Në seancën dëgjimore të datës 8 nëntor, kërkesat buxhetore për këtë institucion u parashtruan nga Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca, e cila për projektbuxhetin e vitit 2023, kërkoi që të merren parasysh shtesat e mëposhtme:

- Shtesën prej 4 punonjësish, me vlerë 7.5 milion lekë shtesë në zërin e shpenzimeve për paga dhe kontribute.
- Shtesë në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 3 milion lekë që do të përdoren për prodhim/ publikim raporte të veçanta, organizime auditoriume, konferenca, trajnime të ndryshme, studime në fusha të veçanta.
- Shtesë në zërin e investimeve për pajisje pajisje zyre në vlerën 2 milion lekë.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vendosi ti propozojë komisionit përgjegjës miratimin e shtesave të mëposhtme:

- *Shtesën prej dy punonjësish, nga të cilët një ndihmëskomisioner në Seksionin për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe një specialist IT, pa efekte financiare shtesë në zërin e shpenzimeve për paga dhe kontribute.*

- *Shtesën në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 3 milion lekë për financimin e kostove administrative që lidhen me veprimtarinë e institucionit.*

21. Për projektbuxhetin e Shkollës së Magjistraturës

Buxheti total i parashikuar për vitin 2023, për Shkollën është rreth 328.6 milionë lekë, nga të cilat:

- 80 milionë lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 65.1 milionë lekë shpenzime për mallra dhe shërbime
- 174.5 transferta për bursat e studentëve të Shkollës
- 9 milion lekë shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të këtij institucioni për vitin 2023 është parashikuar të jetë 40 punonjës.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2022, nëpërmjet aktit normativ nr.12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, rezulton se shpenzimet totale janë rritur me 30 milion lekë, ose 10% më shumë, nga të cilat:

- Shpenzimet për paga janë rritur me 11.4 milion lekë ose 17% më shumë.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur me 16.8 milion lekë ose 35% më shumë.
- Zëri i transfertës për financimin e bursave është rritur me 1 milion lekë.
- Shpenzimet për investime janë rritur me 1 milion lekë.

Në seancën dëgjimore të datës 8 nëntor, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Kancelarja znj.Ela Qokaj, e cila për projektbuxhetin e vitit 2023 për këtë institucion kërkoi që të merret parasysh:

- Shtesë në zërin e transfertës për përbalimin e bursave të studentëve magjistratë për vitin e tretë, të cilat nëse nuk do bëhen ndryshimet ligjore do të duhet të përballohen nga Shkolla dhe përllogariten në vlerën 32 milion lekë shtesë.
- Shtesë në zërin e investimeve në vlerën 576 milion lekë për ndërtimin e godinës së re të Shkollës.

Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vendosi ti kërkojë komisionit përgjegjës miratimin e shtesës në zërin e shpenzimeve korrente, transferta për buxhet. Individëve në vlerën 30 milion lekë, për pagesën e bursave për kandidatët për magjistratë për pranimet për vitin e ardhshëm akademik.

22. Për Projektbuxhetin e Vendor

Në total, për vitin 2023, transferta e pakushtëzuar do të jetë 31.7 miliardë lekë. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme e parashikuar për vitin 2023 është 21.8 miliardë lekë, pra është rritur me 3 miliardë lekë ose 17.6% më e lartë se ajo e vitit 2022.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale për financimin e funksioneve të transferuara në vitin 2016, në projektbuxhetin e vitit 2023, është parashkuar të jetë 9.9 miliardë lekë ose 537 milion lekë më shumë se në vitin 2022, me një rritje prej 13%. Transferta e pakushtëzuar sektoriale për secilin nga funksionet, në krahasim me vitin 2022 ka shënuar rritje si vijon:

- Transferta për arsimin parashkollor është rritur me 2 përqind.
- Transferta për arsimin parauniversitar është rritur me 2 përqind.
- Transferta për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri është rritur me 4 përqind.
- Transferta për administrimin e pyjeve është rritur me 2 përqind.
- Transferta për fondin e ujitjes dhe kullimit është rritur me 2 përqind.
- Transferta për rrugët rurale është rritur me 2%.

Transferta e pakushtëzuar përfshirë dhe sektorialen përfaqëson rreth 49% të të ardhurave të buxhetit vendor.

Në mbledhjen e datës 7 nëntor, kërkesat buxhetore për pushtetin vendor u parashtruan nga anëtarët e Shoqatës për Autonomi Vendore dhe Shoqatës së Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë, të cilët kërkuan nga Komisioni që të merreshin në konsideratë shqetësimet e mëposhtme:

- Funksionet e transferuara në vitin 2016, të cilat shpërndahen nëpërmjet transfertës sektoriale si ujitja e kullimi, arsimit parashkollor dhe parauniversitar, pyjet, mbrojtja nga zjarri dhe rrugët rurale duhet të jenë më të mëdha dhe ku të përfshihen dhe investimet, pasi në projektbuxhet këto fonde pothuajse janë vetëm për përballimin e shpenzimeve për paga.
- Shpenzimet e investimeve publike për rindërtimin të akordohen të plota për të mos cënuar buxhetin e njërive vendore dhe me qëllim që të parandalohet krijimi i detyrimeve të prapambetura.
- Fondi për mbetjet urbane në masën 700 milionë lekë ose 200 milion më shumë se në vitin 2022, që akordohen në programin “Menaxhimi Mbetjeve”, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit do të shpërndahet në formën e transfertës së kushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Projektbuxheti të parashikojë një ndarje në të gjitha bashkitë për investimin fillestar të sistemeve të trajtimit dhe diferencimit të mbetjeve.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vendosi t’i propozojë komisionit përgjegjës marrjen në shqyrtim të problematikave të mësipërme të ngritura nga shoqata si dhe të shikohet mundësia e rritjes së transfertës së pakushtëzuar në raport me PBB-në nga 1% që është aktualisht me qëllim nxitjen e investimeve në zonat rurale.

Anëtarët e Komisionit, gjatë votimit nen për nen të projektligjit i kërkuan përfaqësuesve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të përgatisin një studim për të parë në tërësi legjislacionin që rregullon sistemin e pagave në vendin tonë, në mënyrë që të shmangim pabarazinë e krijuar me piramidën e pagave aktuale.

Të gjitha ndryshimet e miratuara më sipër nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të reflektohen në tabelën 1 të projektligjit “Buxheti 2020 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve të buxhetore”, si dhe në tabelën 2 që parashikon numrin e punonjësve për vitin 2023.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, votoi projektligjin nen për nen dhe në tërësi, me shumicë votash e miratoi atë dhe u shpreh dakord t’i përcillet komisionit përgjegjës për vijimin e procedurës sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

RELATOR

KRYETARE

Klevis XHOXHI

Klotilda BUSHKA

Saimir HASALLA